



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 155, datë 30.07.2018

PËR

MIRATIMIN E KONTRIBUTEVE SHITESË TË FONDIT TË KOMPENSIMIT TË
VITIT 2018

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe pikës 3 dhe 4 të nenit 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 42, e vijues, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në vijim të procesit të ndjekjes së fondit të kompensimit, ka kryer inspektim në vend, pranë shoqërive të sigurimit me objekt: verifikimi i statuseve të praktikave të dëmeve, aktuale dhe të reja, objekt i fondit të kompensimit për ngjarjet pas 1 janar 2014, si dhe pagesat e kryera për këto praktika gjatë periudhës janar-prill 2018.

Në përfundim të rezultateve të inspektimit është konstatuar se dëme të fondit të kompensimit për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim të përfunduara (miratuara pa paguar dhe përmbarimore), ishin në vlerën 226,849,777 lekë.

Për këtë situatë, nisur nga fakti se fondi i miratuar me vendimin nr.217, datë 28.12.2018 “Mbi fondin e kompensimit të vitit 2018”, me qëllim pagesën e dëmeve për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim, është i pamjaftueshëm për pagesën e këtyre dëmeve, është kërkuar nga anëtarët e asamblesë shtesë e këtij fondi, miratuar nga Asambleja me vendimin nr. 13, datë 25.06.2018.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, referuar periudhës deri më 31 maj 2018, të situatës së dëmeve të fondit të kompensimit të papaguara për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim të përfunduara (miratuara pa paguar dhe përmbarimore), sipas kategorive të përcaktuar në vendim, konstaton se vlera e tyre në total është 229,058,962 lekë.

Duke marrë në konsideratë detyrimin e mbetur në zbatim të Vendimit të Bordit nr. 217, datë 28.12.2017, sipas raportimit të BSHS-së me shkresën nr. 3239 prot, datë 14.06.2018, e cila rezulton në vlerën 47,146,797 lekë, shtesa e fondit të kompensimit është në vlerën prej **181,912,165 lekë**.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 45, pika 4, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, miratohet shtesa e fondit të kompensimit për vitin 2018, për pagesat e dëmeve për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim, në vlerën 181,912,165 lekë.
2. Të urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit të shpërndajë dhe të dërgojë menjëherë autorizimet për ndjekjen e procedurës së pagesës pranë shoqërive të sigurimit.
3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI